



**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR
NË LIDHJE ME KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE
(KAB) 2027-2029 – PALDENICË**

Procesverbali nga dëgjimi i dytë buxhetor në lidhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027 - 2029 u zhvillua me datën **02.06.2026** duke filluar nga ora 13:30 në SHFMU “Kështjella e Diturisë” në fshatin Paldenicë, në të cilin ishin gjithsej 13 pjesëmarrës, prej të cilëve 6 ishin gra dhe 7 burra.

Dëgjimin buxhetor e kryesoi Nënkryetari i Komunës z. Sevdin Dërnjani i cili i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen e tyre, ku për rend të ditës kishin:

- 1. Prezentimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029**
- 2. Diskutimi i hapur**

Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 e prezantoi Drejtorja për Buxhet dhe Financa, znj. Lindita Ballazhi.

1. Prezentimi i Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore

Lindita Ballazhi: Duke u bazuar në Ligjin për Financa Publike dhe Përgjegjësitë, Qeveria e Kosovës gjatë muajit maj të këtij viti ka aprovuar Kornizën Afatmesme të shpenzimeve qeveritare apo KASH-in për periudhën 2027-2029, ku në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore të shpenzimeve qeveritare lëshoet Qarkorja e parë buxhetore dhe me kufijtë fillestarë në nivel të Kosovës. Me pranimin e Qarkores së parë buxhetore, kemi kufijtë fillestarë buxhetore me të cilat ne bëjmë planifikimin e buxhetit për vitin vijues apo konkretisht për vitin 2027, si dhe parashikimet e hershme për vitin 2028-2029, me ç'rast ne bëjmë hartimin e shpenzimeve duke renditur prioritetet kryesore komunale dhe normalisht objektivat të cilat janë të identifikuar në dokumente strategjike komunale. Fazat për zhvillimin e KAB-it komunal dhe afatet kohore janë: në maj Pranimi i Qarkores fillestare Buxhetore 01/2027, Draftimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029, në qershor Konsultimet me Asambleenë Komunale, Mbajtja e Debateve Buxhetore dhe Aprovimi i KAB-it në KPF dhe Kuvend Komunal deri me 30 qershor.

Për vitin buxhetor 2027 Buxheti i Komunës do të jetë 4,564,793.00 €, Ndërkaq tani presim projekt propozimet tuaja për vitin buxhetor 2027.

2. Diskutimi i hapur

Ahmet Krasniqi thekson: Sa i përket projekteve kapitale do të ishte mirë të asfaltohet rruga për në fshatin Vërtomicë, duke qenë se ka mbet i vetmi fshat pa asfaltim, se i kemi 2,3 fermerë të cilët dalin atje si dhe banorët i kanë tokat atje. Poashtu, do të ishte mirë të bëhet një intervenim edhe tek varrezat pasi që vetëm varrezat e këtij vendi nuk janë rregulluar.

Sevdi Dernjani thekson: A e keni fjalën për varrezat e fshatit Vërtomicë?

Ahmet Krasniqi thekson: Po për në Vërtomicë bëhet fjalë.

Lindita Ballazhi thekson: E kemi projektin e rregullimit të varrezave.

Sevdi Dernjani thekson: Në vitin 2024 ne e kemi bërë paramasën e këtij projekti të rrugës për në Vërtomicë, vlera e të cilit është rreth 400,000.00 €. Por fatkeqësisht, nuk kemi gjetur mbështetje prej nivelit qendror për ta realizuar këtë projekt. Por, mundësia e parë që do të na ofrohet, ne e kemi gatishmërinë ta realizojmë këtë projekt. Ta shikojmë çka mundemi të bëjmë për vitin 2027.

Ahmet Krasniqi thekson: Poashtu, rregullimi i prockave. Se janë edhe të rrezikshme. Është mirë t'i hartoni si projekte dhe pse jo të realizohen nëse ka fonde apo gjeni mbështetje tjera.

Sevdi Dernjani thekson: Faleminderit për propozimet.

Amir Derjani thekson: Projekti i trotuareve a është në vazhdim?

Sevdi Dernjani thekson: Nëse nuk gaboj trotuaret për sivjet duhet të rregullohen prej te shkolla deri te shpija e pritjes.

Lindita Ballazhi: Ne kemi mbajtur procesverbal të këtij debati dhe të gjitha propozime tuaja do të shqyrtohen sërish. Nëse dikush ka ndonjë pyetje tjetër apo propozim, mundeni edhe të më drejtorheni në emailin tim Lindita.ballazhi@rks-gov.net apo edhe kërkesat tuaja ti dërgoni fizikisht tek Qendra për Shërbim me Qytetarë, e më pas ne do t'i shqyrtojmë të gjitha kërkesat, sugjerimet, rekomandimet dhe propozimet tuaja, si ato gjatë këtij dëgjimi, ashtu edhe ato përmes emailit dhe përmes dërgimit të QSHQ. Nëse nuk ka tjetër diskutim apo propozim, e konsideroj të mbyllur dëgjimin buxhetor.

Debati publik përfundoi në orën 14:00.

Procesmbajtësja
Lindita Ballazhi

